

Shqip

Argumentim për mosndarjen në lote për procedurën me objekt: “Sistemimi dhe mirëmbajtja e rrugëve bujqësore”

Mosndarja në lote e zërave të përfshirë në këtë procedurë justifikohet nga natyra e integruar dhe funksionalisht e pandashme e shërbimeve që do të realizohen në rrugët bujqësore. Zërat e preventivit nuk përbëjnë shërbime të pavarura, por ndërhyrje që plotësojnë njëra-tjetrën dhe që duhet të realizohen në mënyrë të koordinuar për të garantuar funksionalitetin, sigurinë dhe jetëgjatësinë e infrastrukturës rrugore.

Shërbimet përfshijnë pastrimin e kanaleve kulluese, pastrimin e tombinove ekzistuese, pastrimin e vegjetacionit anësor, pastrimin e karrexhatës nga aluvionet dhe materiale të tjera, mbushjen dhe profilimin e rrugëve të shtruara me çakull, si dhe mirëmbajtjen rutinë të veprave të artit. Këto ndërhyrje janë teknikisht të ndërvarura dhe realizohen në të njëjtat segmente rrugore, duke synuar rivendosjen dhe ruajtjen e funksionalitetit të sistemit rrugor dhe të kullimit të ujërave.

Ndarja e këtyre shërbimeve në lote të veçanta do të krijonte fragmentim të panevojshëm të procesit të shërbimit dhe do të rrezikonte koordinimin ndërmjet operatorëve ekonomikë. Për shembull, pastrimi i kanaleve dhe tombinove është i lidhur drejtpërdrejt me largimin e aluvioneve nga karrexhata dhe me sigurimin e kullimit normal të ujërave, ndërsa pastrimi i vegjetacionit është i domosdoshëm për të mundësuar aksesin dhe ndërhyrjen në kanale, tombino dhe veprat e artit. Po ashtu, mbushja dhe profilimi i rrugëve me çakull realizohet pas pastrimit të sipërfaqes rrugore dhe sistemit të kullimit, në mënyrë që ndërhyrja të jetë e qëndrueshme dhe të mos dëmtohet nga ujërat sipërfaqësore. Kryerja e këtyre proceseve nga operatorë të ndryshëm do të krijonte vështirësi në koordinimin e shërbimeve, do të rriste rrezikun e mbivendosjes së aktiviteteve dhe do të ndikonte negativisht në cilësinë përfundimtare të shërbimit.

Gjithashtu, të gjitha këto shëe kërkojnë përdorimin e të njëjtave makineri, mjete dhe personel teknik, si eskavatorë, ngarkues, autogrejderë, kamionë transporti dhe pajisje të tjera ndihmëse, të cilat shfrytëzohen në mënyrë të vazhdueshme gjatë gjithë procesit të mirëmbajtjes. Realizimi i kontratës nga një operator i vetëm ekonomik mundëson planifikim më efikas të burimeve, organizim më të mirë të shërbimeve, ulje të kostove operative dhe administrative, si dhe kontroll më të lehtë të cilësisë dhe të afateve të zbatimit.

Nga ana tjetër, ndarja në lote do të rriste ndjeshëm ngarkesën administrative për autoritetin kontraktor, pasi do të kërkonte zhvillimin e procedurave dhe administrimin e disa kontratave të veçanta, koordinimin ndërmjet disa kontraktorëve që do të operonin në të njëjtat segmente rrugore, si dhe përcaktimin e përgjegjësisë në rast të defekteve ose vonesave gjatë zbatimit të shërbimeve.

Një situatë e tillë do të cenonte efikasitetin e realizimit të kontratës dhe përdorimin racional të fondeve publike.

Për këto arsye, mosndarja në lote vlerësohet si zgjidhja më e përshtatshme nga pikëpamja teknike, organizative dhe ekonomike, pasi garanton realizimin e koordinuar të të gjitha ndërhyrjeve të nevojshme, siguron një standard të njëtrajtshëm cilësie, optimizon përdorimin e burimeve njerëzore, teknike dhe financiare, si dhe mundëson një menaxhim më efikas të kontratës nga autoriteti kontraktor.

Gjithashtu, referuar nenit 14 të Ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *"Grupe operatorësh ekonomikë mund të dorëzojnë oferta ose të paraqiten si një kandidat i vetëm sipas parashikimeve në rregullat e prokurimit publik. Autoriteti ose enti kontraktor nuk duhet t'i kërkojë një formë të veçantë ligjore bashkimit të shoqërive, për qëllim të dorëzimit të ofertës ose kërkesës për pjesëmarrje. Autoritetet ose entet kontraktore mund t'u kërkojnë grupeve të operatorëve ekonomikë që të marrin një formë ligjore specifike, pasi të jenë shpallur fitues, nëse vlerësohet e nevojshme për realizimin e kontratës. Në çdo rast, ky kusht duhet t'u bëhet i ditur operatorëve ekonomikë në dokumentet e tenderit për ekzekutimin e kënaqshëm të kontratës."*

English

Justification for Not Dividing the Procurement into Lots for the Procedure with the Subject: "Improvement and Maintenance of Agricultural Roads"

The decision not to divide this procurement procedure into lots is justified by the integrated and functionally indivisible nature of the services to be carried out on the agricultural road netpun. The items included in the bill of quantities do not constitute independent services but rather complementary interventions that must be implemented in a coordinated manner to ensure the functionality, safety, and durability of the road infrastructure.

The services include the cleaning of drainage channels, cleaning of existing culverts, removal of roadside vegetation, cleaning of the carriageway from alluvial deposits and other materials, filling and grading of gravel roads, as well as routine maintenance of engineering structures. These interventions are technically interdependent and are carried out on the same road sections with the objective of restoring and maintaining the functionality of both the road network and the drainage system.

Dividing these services into separate lots would create unnecessary fragmentation of the service process and would jeopardize coordination among different economic operators. For example, the cleaning of drainage channels and culverts is directly linked to the removal of alluvial deposits from the carriageway and to ensuring the proper drainage of surface water, while the removal of roadside vegetation is necessary to enable access to drainage channels, culverts, and engineering structures.

Likewise, the filling and grading of gravel roads can only be effectively performed after the carriageway has been cleaned and the drainage system has been restored, thereby ensuring the durability of the intervention and preventing damage caused by surface water. Carrying out these activities through different contractors would complicate the coordination of services, increase the risk of overlapping activities, and negatively affect the overall quality of the services provided. Furthermore, all of these activities require the use of the same machinery, equipment, and technical personnel, such as excavators, loaders, motor graders, transport trucks, and other supporting equipment, which are utilized continuously throughout the maintenance process. Execution of the contract by a single economic operator allows for more efficient planning of resources, better organization of the services, reduced operational and administrative costs, and more effective monitoring of quality and compliance with implementation deadlines.

Conversely, dividing the procurement into lots would significantly increase the administrative burden on the Contracting Authority, as it would require the management of multiple procurement procedures and separate contracts, continuous coordination among several contractors operating on the same road sections, and the allocation of responsibilities in the event of defects or delays during contract implementation. Such an approach would adversely affect the efficiency of contract execution and the rational use of public funds.

For these reasons, the decision not to divide the procurement into lots is considered the most appropriate solution from a technical, organizational, and economic perspective, as it ensures the coordinated implementation of all necessary interventions, guarantees a consistent quality standard, optimizes the use of human, technical, and financial resources, and enables more efficient contract management by the Contracting Authority.

Furthermore, pursuant to Article 14 of Law No. 162/2020 **"On Public Procurement,"** it is expressly stipulated that:

"Groups of economic operators may submit tenders or participate as a single candidate in accordance with the provisions of the public procurement rules. The contracting authority or contracting entity shall not require such groups to adopt a specific legal form for the purpose of submitting a tender or a request to participate. Contracting authorities or contracting entities may require groups of economic operators to adopt a specific legal form after they have been awarded the contract, where this is deemed necessary for the proper performance of the contract. In any case, this requirement shall be made known to the economic operators in the tender documents in order to ensure the satisfactory performance of the contract."